RELACION TEKNIK
(PROJEKT ME PËRSHKRIM)

Mirëmbajtje rutinë me performance **"Fierzë-B.Curri , B.Curri - Cërrnicë , D/Sopot-Kam " 48.2 km**

- **Qëllimi i shërbimeve që do kryhen :**

Shërbimet që do mundësohen përfshijnë gjithë veprimtaritë, fizike dhe të tjera, që duhet të kryhen nga kontraktori, sipas përputhshmërise së tyre me nivelet e shërbimit bazuar ne zbatimin e te gjitha specifikimeve teknike.
Në veçanti, ato përfshijnë detyrat menaxheriale dhe punimet fizike që lidhen me kategorite e punimeve te meposhtme:
-Asfaltimet
-Nivelimi i Bankinave.
-Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikes vertikale dhe horizontale (dhe ndriçimit nese ka).
-Strukturat e drenazhimit (kanale, kuneta, tombino etj)
-Kontrolli i vegjetacionit
-Skarpatat (nivelimet dhe hapja e fushepamjes nga bimesia.)
-Kontrolli, riparimi dhe mirembajtja e veprave te artit
-Riparimi dhe rifreskimi barrierave mbrojtese metalike apo parapeteve prej betoni.
-Menaxhimi i trafikut gjatë kryerjes së punimeve.
- Pastrimi i dëborës (nqs ka mirëmbajtje dimërore)

Shërbimet që kërkon Mirëmbajtja e një rruge klasifikohen në keto kategori punimesh:

- **Shërbimet e Mirëmbajtjes Rutinë** në formën e sasisë së shprehur në një vlerë tavan mujore (kjo do jetë një sasi mujore e aplikueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes se kontratës se shprehur në çmim për kilometër për secilin muaj e shumëzuar me gjatësinë e rrugës dhe kohëzgjatjen e shërbimeve).
- **Punimet e Rehabilitimit**, në formën e sasisë së një vlere tavan, ndërsa tregohen sasitë e punimeve të matëshme që do kryhen në mënyrë që rruga të arrijë Standardet e asaj performancë.
- **Punimet Emergjente** në formën e një preventivi tradicional.

Funksionet kryesore të bazave të mirëmbajtjes në përgjithësi, duhet të jenë si më poshtë:

1. Mbikëqyrja e segmentit/seksionit rrugor në periudha të caktuara sipas niveleve të shërbimit.
2. Vëzhgimi i faktorëve meteorologjikë dhe marrja e masave sipas situatave.
3. Mirëmbajtje në kushtet e dëshiruara të shtresave rrugore.
4. Mirëmbajtja e hapësirave të parkimit, shërbimit, shenjave rrugore, sistemeve të ndriçimit, dhe sinjalizimit.
të ardhshëm e telekomunikacionit.
5. Riparime dhe rindërtim pas aksidenteve rrugorë.
6. Riparime dhe rindërtim pas fatkeqësive natyrore.

7. Operacionet e pastrimit të drenazheve, tombinove dhe objekteve të tjera që lidhen me largimin e ujrave nga sipërfaqja e rrugës
8. Të gjithë operacionet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e :

- shenjave rrugore, pajisjeve të sigurise (barrierave, parapeteve etj.) sistemi i ndricimit.
- riparimi lokal i dëmtimeve të trotuarit
- kujdesi për bimesinë
- aktiviteti në dimer për largimin e dëborës dhe akullit.

Punimet e mirëmbajtjes në kushtet dimërore (nqs ka), përfshijnë:
1. Punime paraprake para fillimit të kushteve të dimrit.
2. Organizimi i vendodhjeve të depozitimit të materialeve (kripes dhe mjeteve)
3. Masat mbrojtëse për borën, akullin, grumbujt e borës dhe ortekët.
4. Organizimin per raportimin e informacionit 24 ore/24 organeve kompetente..

- **Segmentet që mbulon kontrata :**

Nr.	Emertimi I segmentit	Koordinata e fillimit	Koordinata e mbarimit	Gjatesia	Gjeresia
				km	ml
1	Fierzë-B.Curri	42.256091, 20.032948	42.356986, 20.079669	16.3	6
2	B.Curri - Cërrnicë	42.356986, 20.079669	42.362597, 20.110781	4.2	6
3	D/Sopot-Kam	42.371359, 20.119054	42.279122, 20.218858	27.7	4
			SHUMA TOTALE KONTRATA 2	**48.2**	

- **Kusht i veçantë**

Për çdo rast, nga kontrata do të zbriten segmente të saj, neqoftese do të përfshihen në investim (rikonstruksion) apo projekte të tjera të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

- **Sinjalistika dhe siguria rrugore**

Mirëmbajtja e sinjalistikës dhe siguria rrugore (barrierat) do të fokusohet tek riparimi dhe rifreskimi e asaj ekzistuese.

- **Përshkrimi i zonës ku ndodhet rruga.**

Fierzë-B.Curri 16.3 km

Ky segment rrugor eshte rruga lidhese e qytetit te Bajram Currit me Hidrocentralin e Fierzes dhe me qytetet F.Arrez, Puke etj..
Eshte segment I asfaltuar, me nje karregjate (gjeresi 6 ml).
Shtresat asfaltike janë në kushte të mesatare te mira..
Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.
Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë plotesim te metejshem dhe për mirembajtje te vazhdueshme.
Rruga shtrihet ne nje terren te theksuar malor dhe ka mirëmbajtje dimërore.
Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.



B.Curri - Cërrnicë 4.2 km

Eshte segment I asfaltuar, me nje karregjate (gjeresi 6 ml).
Shtresat asfaltike janë në kushte të mesatare.
Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.
Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë plotesim te metejshem dhe për mirembajtje te vazhdueshme.
Rruga shtrihet ne nje terren te theksuar malor dhe ka mirëmbajtje dimërore.
Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.



D/Sopot-Kam 27.7 km

Ky segment rrugor eshte rruga lidhese e qytetit te Bajram Currit qytetin e Kukesit.

Eshte segment i asfaltuar, me nje karregjate (gjeresi 4 ml).
Shtresat asfaltike janë në kushte të mesatare te mira..
Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.
Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë plotesim te metejshem dhe për mirembajtje te vazhdueshme.
Rruga shtrihet ne nje terren te theksuar malor dhe ka mirëmbajtje dimërore.



GRUPI I PUNES:

Ing _____ Ing _____ Ing _____